
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Datë/a:	12.09.2018
Për/ Za/ To:	Albi Company, Rahovec
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “ALBI COMPANY”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Renovimi i ndertesave për mbrojtje të trashëgimise kulturore**”, me Nr. të Prok: **616 18 77 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar** kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “Albi Company” të dt. 07.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i ndertesave për mbrojtje të trashëgimise kulturore**”, me Nr. 616-18-4828-512 dhe Nr. Brendshëm 616 18 77 512, kundër Vendimit të AK –së, të datës 04.09.2018.
2. **Mbetet në fuqi** vendimi i AK datë: 04.09.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull “**Renovimi i ndertesave për mbrojtje të trashëgimise kulturore**”, me Nr. Brendshëm 616 18 77 512 ta vazhdoj me vendimin për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 29.06.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimiti: “**Renovimi i ndertesave per mbrojtje te trashegimise kulturore**”, me Nr. 616-18-77-5-1-2, procedura e hapur.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 23.07.2018. Janë dorëzuar gjithsej 4 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Me datë 15.08.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE “Albi Company, me dt. 16.08.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim, kërkesë e cila është miratuar nga AK dhe lënda është kthyer ne rivlerësim.

Pas përfundimit të procesit të ri-vlerësimit, me datë 04.09.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

Me datë 04.09.2018, OE “Albi Company” , i është lejuar qasja në dokumentacion lidhur me këtë aktivitet.

OE “Albi Company, me dt. 07.09.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i ndertesave per mbrojtje te trashegimise kulturore**”, me Nr. 616-18-77-5-1-2, kundër vendimit të AK , në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Neni 1: Qëllimi

Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 56: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e Kontratave

Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60: Kriteret për dhënie të Kantatës (neni 28 RUOPP)

Neni 69: Aftësitë Teknike dhe profesionale

I. Baza ligjore

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon OE "Albi Company"", Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e tenderëve ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 1: Qëllimi** - sipas këtij neni qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. AK e ka respektuar këtë nen duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet sepse OE i shpërblyer me kontratë ka përmbushur te gjitha kërkesat e parashtruara ne DT.
2. **Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar te gjithë OE ne mënyre te barabarte, dhe ka shpërblyer me kontrate OE qe ka përmbushur te gjitha kërkesat e parashtruara ne DT.
3. **Neni 56: Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do vlerësoj tenderët ne përputhje me kërkesat parashtruara ne DT, gjë te cilën AK e ka respektuar.
4. **Neni 59 "Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve"** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do vlerësoj tenderët ne përputhje me kërkesat parashtruara ne DT, gjë te cilën AK e ka respektuar.
5. **Neni 60 "Kriteri për dhënie te kontratës"** - sipas këtij neni AK do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; ose 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet, pra ka respektuar nenin 60.1.1 pasi kriteri i shpërblimit ne Njoftimin për kontratë dhe ne DT ka qene tenderi i përgjegjshme me çmimin me te ulet.
6. **Neni 69 "Aftësitë Teknike dhe profesionale"** - Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. AK gjatë vlerësimit ka respektuar ne përpikëri këtë nen. Sa i përket kërkesës se parashtruar ne DT dhe ne Njoftim për kontratë ne lidhje me nenin 69 "Aftësitë Teknike dhe profesionale" dhe pretendimit te OE:

Kërkesa e parashtruar ne DT dhe pretendimi i OE ne lidhje me kërkesën 1 mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa	Dëshmia
<p>9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p> <p>1. OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontratë punë te ngjashme (për renovim të objekteve trashëgimore) ne tri vitet e fundit (deri ne datën e publikimit te njoftimit) ne vlere minimale 50,000.00 €.</p>	<p>1. Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit (deri ne datën e publikimit te njoftimit) për punë - te ngjashme (renovim të objekteve trashëgimore) të dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve në 3 vitet e fundit në vlerën minimale prej 50,000.00 €, duke saktësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - punët e përfshira, - shumën e kontratës, - datën dhe pranuesin.

Pretendimi #1 i OE

OE i shpërblyer me kontratë nuk ka plotësuar kriterin pasi qe nuk ka ofruar kontratat dhe referenca te natyres se njejte (renovim te objekteve te trashëgimise kulturore).

Arsyetimi i AK

AK vlerëson se OE i shpërblyer me kontratë plotëson kriterin e përcaktuar pasi qe ka përmbush kushtin min. 50,000.00, shih me poshtë disa nga kontratat e prezantuara nga OE i shpërblyer me kontratë.

LISTA E KONTRATAVE TE pranuara "ARHIKO ING"

Nr.	Data e nënshkruar	NR. I prokurimit	AK	TITULLI	CMIMI	Komenti i Albi Company	Komenti i AK
1	28.10.2016	0095982	UNDP	Construction Works (Renovation of Catholic Church Former Seat of the Diocese Ferizaj)	91,211.64	Kontrata është realizuar vetëm 80%	Nuk është marr parasysh sepse nuk është përfunduar 100%
2	14.10.2016	0095982	UNDP	Construction Works Serbian Orthodox Cemetery Chapel	29,863.65		Pranuar
3	25.10.2016	0095982	UNDP	Construction works for complex of buildings "Mulla Vesel Guta (xhamia e madhe) Mosque and SOC st. Uros Ljghetin and Yard Upgrading (listed Cultural heritage) in Ferizaj	19,251.00		Pranuar
4	28.09.2018	005982	UNDP	Lot 1 - Town Mulla Sherif Ahmeti Mosque Yard Upgrading in Lipjan	41,442.00		Pranuar
TOTAL					60,693.00		

Provë I: Konstatimi dhe Dëshmia zyrtare e UNDP-së përmes emailit zyrtar të datës: 30.08.2018, se këto kontrata janë të natyrës së trashëgimisë kulturore për renovim dhe restaurim.

Provë 2: Ligji për Trashëgimi Kulturore Nr.02/L-88, në nenin 6 par.3, par.4 dhe par.5 e cila thekson:

Neni 6, par.3. "Monumentet arkitekturale rriten në të gjitha elementet e tyre përbërëse, (poret arkitekturale dhe teknike, hapësira e mbrojtës së monumentit përshim secilin udhëtim ose strukturë të rrethës së pranuar brenda perimetrit të monumentit, dhe përcaktohet në një plan të Institucionit kompetent"

Neni 6, par.4. "Monumentet arkitekturale në mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin institucionit kompetent dhe në planin hapësiror relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësiror".

Neni 6, par.5. "Ansamblet (tërësitë) dhe hapësirat e konservuara arkitekturale në mbrojtje mund të jenë në ambiente rurale ose urbane. Ndërfesat e përfshira në ansamble dhe hapësira të tilla janë të mbrojtura nga jashtë, dhe përcaktohen si sferëjaq të mbrojtura në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësiror, dhe mund të klasifikohet si zonë e rrethës në pajtueshmëri me nenin 12 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësiror".

Kërkesa e parashtruar ne DT dhe pretendimet e OE ne lidhje me kërkesën 2 mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa	Dëshmia
<p>9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p> <p>2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon:</p> <p>a) Një Menaxher - Inxhinier i arkitekturës - (minimum 3 vite përvojë pune lidhur me punë restauruese dhe konservuese në trashëgimi kulturore);</p> <p>b) Një inxhinier i ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv (minimum 3 vite përvojë pune lidhur me punën për konservim dhe restaurim në trashëgimi kulturore);</p> <p>c) Një Inxhinier të ndërtimtarisë - Drejtimi Hidroteknik.</p> <p>d) Një Inxhinier të Elektroteknikës.</p> <p>e) Një mjeshtër druri - (me përvojë në fushën e trashëgimisë kulturore).</p>	<p>2. Duhet dorëzuar si dëshmi: Kopjet e Diplomave, CV e tyre që dëshmojnë përvojën e tyre me më se paku tre vite dhe kontrata për marrëdhënie pune valide për vitin 2018-2019.</p>

Pretendimi #2 i OE

- a. Menaxheri- Inxhinier i arkitekturës i OE te shpërblyer me kontratë nuk ka dëshmi se ka përvojë pune min. 3 vite lidhur me punë restauruese dhe konservuese në trashëgimi kulturore. Ne CV e dorëzuar ceket se projekt menaxheri ka punuar te PMN dhe ka vërtetuar me referencën e punës nga OE. PMN por nuk mund të merret parasysh sepse është fiktive.
- b. Inxhinieri i ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv i OE te shpërblyer me kontratë nuk ka dëshmi se ka përvojë pune min. 3 vite lidhur me punë restauruese dhe konservuese në trashëgimi kulturore. Ne CV e dorëzuar ceket se projekt menaxheri ka punuar te PMN dhe ka vërtetuar me referencën e punës nga OE. PMN prandaj nuk mund të merret parasysh sepse është fiktive.
- c. Mjeshtër druri - (me përvojë në fushën e trashëgimisë kulturore) i OE te shpërblyer me kontratë nuk ka dëshmi se është mjeshtër i zduktharise sic është kërkuar ne dëshminë nr. 2 pasi ka dorëzuar kopje te diplomës fiktive.

Arsyetimi i AK

- a. Në lidhje me kërkesën Menaxher - Inxhinier i arkitekturës të OE të shpërblyer me kontrate - Dëshmia e kërkuar për stafin e OE e përcaktuar në dosje të tenderit është: Kopjet e Diplomave, CV e tyre që dëshmojnë përvojën e tyre me më së paku tre vite dhe kontrata për marrëdhënie pune valide për vitin 2018-2019. Kërkesa nuk ka qene që përvoja të dëshmohet me reference. OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara (Kopjen e Diplomës, CV dhe kontratën e punës) dhe në këtë mënyre ka përmbush kushtin e përcaktuar nga AK, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-se dhe është shpallur fitues herën e parë. Mirëpo pas kërkesës suaj për rishqyrtim, AK për shkak të dyshimit të ngritur nga ju AK ka kërkuar sqarime shtese nga OE, në përputhje me nenin 72, dhe OE ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "referencën" e cila nuk ka qenë kriter në dosje të tenderit) dhe në këtë mënyre ka përmbush kushtin e përcaktuar nga AK, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-se.
- b. Në lidhje me kërkesën Inxhinieri i ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv të OE të shpërblyer me kontrate - Dëshmia e kërkuar për stafin e OE e përcaktuar në dosje të tenderit është: Kopjet e Diplomave, CV e tyre që dëshmojnë përvojën e tyre me më së paku tre vite dhe kontrata për marrëdhënie pune valide për vitin 2018-2019. Kërkesa nuk ka qene që përvoja të dëshmohet me reference. OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara (Kopjen e Diplomës, CV dhe kontratën e punës) dhe në këtë mënyre ka përmbush kushtin e përcaktuar nga AK, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-se dhe është shpallur fitues herën e parë. Mirëpo pas kërkesës suaj për rishqyrtim, AK për shkak të dyshimit të ngritur nga ju AK ka kërkuar sqarime shtese nga OE, në përputhje me nenin 72, dhe OE ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "referencën" e cila nuk ka qenë kriter në dosje të tenderit) dhe në këtë mënyre ka përmbush kushtin e përcaktuar nga AK, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-se.
- c. Në lidhje me kërkesën Mjeshtër Druri të OE të shpërblyer me kontrate - Dëshmia e kërkuar për stafin e OE e përcaktuar në dosje të tenderit është: Kopjet e Diplomave, CV e tyre që dëshmojnë përvojën e tyre me më së paku tre vite dhe kontrata për marrëdhënie pune valide për vitin 2018-2019. OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara (CV dhe kontratën e punës) por ka munguar kopja e diplomës. Prandaj aktiviteti i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim. AK ka kërkuar sqarime shtese nga OE, në përputhje me nenin 72, dhe OE ka dorëzuar diplomën dhe në këtë mënyre ka përmbush kushtin e përcaktuar nga AK, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-se.

- d. OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara (CV dhe kontratën e punës dhe Diplomën) ne këtë mënyrë ka përmbush kushtin e përcaktuar nga AK, ne përputhje me nenin 59.4 të LPP-se.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Flamur Sallahu

From: Vehbi Selmani <vehbi.selmani@undp.org>
Sent: 30 August, 2018 09:55
To: Flamur Sallahu
Cc: 'arhiko.ing@gmail.com'
Subject: RE: Request for your advise!

Dear Flamur,

Thank you for contacting UNDP regarding to your queries.
For your information, the Project Manager has left UNDP while ago. I was engaged as a Project specialist to support Implementation of the CPCHP *Confidence Building through renovation of Cultural Heritage Project*, thus I am answering on PM behalf.

The economic Operator "ARHIKO" Pristina was engaged to Implement projects as stated in your table and satisfactorily completed mentioned projects.

As per UNDP standards, the mentioned works performed by "ARHIKO" are classified as **renovation of heritable facilities**.

Should you need any additional information please do not hesitate to contact me.

PS.

There is one typing mistake on the given table. Row nr 3 should read "Data e nenshkruar" 28.09.2016 instead of 28.09 2018.

3	28.09.2018 28.09.2016	005982	UNDP	Lot 1 – Town Mulla Sherif Ahmeti Mosque Yard Upgrading in Lipjan	41,442.00
---	--------------------------	--------	------	---	-----------

Qdo te mire

Vehbi Selmani
Project manager
"Dealing with conflict legacy in Kosovo and Serbia" Project
Mob: +383 49 785 915
Tel: + 383 38 249 066 Ext 426
Fax: + 383 38 249 065
e-mail: Vehbi.selmani@undp.org
Skype: vehbi.selmani

From: Flamur Sallahu <Flamur.Sallahu@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, August 29, 2018 1:52 PM
To: Vehbi Selmani <vehbi.selmani@undp.org>
Cc: 'arhiko.ing@gmail.com' <arhiko.ing@gmail.com>
Subject: Request for your advise!

Dear Sir,

In-regard to a procurement activity, which Prishtine Municipality is conducting, an Economic Operator, "ARHIKO, Prishtina, as requested has submitted a list of contracts implemented and copies of the references. As a reference for the contracts it is declared that you were the Project manager for the following contracts:

Nr.	Data e nënshkruar	NR. I prokurimit	AK - Authority	TITULLI - Title	CMIMI - Price
1	14.10.2016	0095982	UNDP	Construction Works Serbian Orthodox Cemetery Chapel	29,863.65
2	25.10.2016	0095982	UNDP	Construction works for complex of buildings "Mulla Vesel Guta (xhamia e madhe) Mosque and SOC st. Uros Lighetnin and Yard Upgrading (listed Cultural heritage) in Ferizaj	19,251.00
3	28.09.2018	005982	UNDP	Lot 1 – Town Mulla Sherif Ahmeti Mosque Yard Upgrading in Lipjan	41,442.00

In the tender dossier we have requested that The EO must provide sufficient evidence that he has contracted similar works (**renovation of heritable facilities**) .

Can you please advise if the mentioned contracts can be classified as **renovation of heritable facilities**.

We thank you for your cooperation.

Best regards

Flamur Sallahu

Zyrtar i Lartë i Prokurimit

Kabineti i Kryetarit – Komuna e Prishtinës

e-mail: flamur.sallahu@rks-gov.net

Tel: 038 244 613

Lokal: 038 230-900; lok: 1186

LIGJI NR. 02/L-88

PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Kuvendi i Kosovës

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullatives ligjore përkitazi me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1. Objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, të krijuara gjatë shekujve, gjithashtu mjetet legale dhe teknike për inventarizim, dokumentim, selektimi mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të këtyre thesareve në pajtim me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje. Vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës.

1.2. Ky ligj vendos marrëdhëniet midis pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore, qofshin ata individë ose komunitete ose autoritete publike - përgjegjës për vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Kjo gjithashtu do të krijojë përgjegjësitë e personave privatë dhe institucioneve publike në lidhje me trashëgiminë kulturore.

1.3. Trashëgimi kulturore në kuadër të këtij ligji përfshinë: trashëgiminë arkitekturale, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtimit, tipi i ndërtimit, përfituesit, krijuesit ose implementuesit e punës. Shtrirja e ligjit duhet të jetë e përkufizuar për çështjet që ndërlidhen në mënyrë specifike me trashëgiminë kulturore. Edhe trashëgimia kulturore që ndërlidhet ose derivon nga konfesionet fetare do të jetë e qeverisur nga legjislacioni i cili rregullon statusin e komuniteteve fetare në Kosovë.

1.4. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë legalisht fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.

Neni 2

Definimi i nocioneve në kontekstin e ligjit

2.1 "**Trashëgimi kulturore**" përfshin trashëgiminë arkitekturale, trashëgiminë arkeologjike, trashëgiminë e luajtshme dhe trashëgiminë shpirtërore.

2.2 "**Trashëgimi arkitekturale**" përbëhet nga:

- a). Monumentet: Konstruktivet dhe strukturat e dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike shkencore me interes shoqëror ose teknike duke përfshirë elementet e luajtshme si pjesë të saj.

për qasje publike për një periudhë kohore afat i arsyeshëm e cila do të përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 5

Financimi dhe masat fiskale për trashëgiminë kulturore

5.1. Fondet për hulumtimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, prezantimin dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe përmes burimeve financiare të autoriteteve lokale dhe ndonjë burimi tjetër vendor dhe ndërkombëtar qoftë ai donacion ose sponsorim.

5.2. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës mbi trashëgiminë kulturore përdoret për mbulimin e veprimeve në lidhje me trashëgiminë kulturore në pajtueshmëri me nenin 4 të këtij Ligji. Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse, ndërsa Ministria është përgjegjëse për aprovimin dhe implementimin e këtyre projekteve në baza proporcionale nga buxheti i saj.

5.3. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme lirohet nga tatimi mbi pronën, në pajtim me këtë ligj.

5.4. Çdo investim me qëllim konservimi dhe restaurimi në trashëgiminë kulturore të mbrojtur, nga personat juridikë ose fizikë, shumat e të cilave janë të konfirmuara dhe aprovuara nga Institucioni kompetent, lirohet nga detyrimi për tatimin në të hyra deri në vlerën e shumës së investuar nëse kjo nuk është rregulluar ndryshe me ndonjë legjislacion tjetër në fuqi.

5.5. Trashëgimia kulturore në pronësi private që është e lejuar për publikun, sipas nenit 4.23 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi trashëgimi.

Neni 6

III. Trashëgimi arkitekturale

6.1. Trashëgimi arkitektural është pjesë e trashëgimisë të paluajtshme. Ajo përbëhet nga monumentet, ansamblet (tërësitë) dhe hapësirat arkitekturale konservuese. Trashëgimi arkitektural daton prej para-historisë deri në kohën e tashme.

6.2. Inventarizimi, dokumentimi dhe mbrojtja e trashëgimisë arkitekturale rregullohet sipas nenit 3 dhe 4 të këtij Ligji. Vlerësimi profesional dhe shkencor për vlerat e saj shënohet në Listën e trashëgimisë kulturore.

6.3. Monumentet arkitekturale ruhen në të gjitha elementet e tyre përbërëse, tiparet arkitekturale dhe teknike. Hapësira e mbrojtjes së monumentit përfshin secilin ndërtim ose strukturë të vlerës së pranuar brenda perimetrit të monumentit, dhe përcaktohet në një plan të Institucionit kompetent.

6.4. Monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

6.5. Ansamblet (tërësitë) dhe hapësirat e konservuara arkitekturale nën mbrojtje mund të jenë në ambiente rurale ose urbane. Ndërtesat e përfshira në ansamble dhe hapësira të tilla janë të mbrojtura nga jashtë, dhe përcaktohen si sipërfaqe të mbrojtura në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor, dhe mund të klasifikohet si zonë e veçantë në pajtueshmëri me nenin 12 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

6.6. Politikat për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale përcaktohen së bashku nga Institucioni kompetent dhe autoritetet qendrore dhe lokale për planifikim hapësinor.

6.7. Çdo punë për modifikim ose demolim të një monumenti arkitektural ose ndonjë veprim konservues ose restaurues që mund të ndikojë në vlerat atribuese të monumentit, kërkon pëlqimin me shkrim të Institucionit kompetent.